



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec RAHOVEC / ORAHOVAC
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovac



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/15 Nr. i faq/Br./str./No.pg 3

Data/Datum/Date 19 / 11 / 2019

PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **18.10.2019**, me fillim në ora **10:00**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, nënkryetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, përfaqësuesit e OSBE-së, të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm. Të nderuar anëtarë të KPF-së për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën kohore Janar-Shtator 2019,**
3. **Shqyrtimi i Informatës së DKA-së për fillimin e vitit të ri shkollorë 2019-2020,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi – Të nderuar anëtarë të KPF-së e vë në votim rendin e ditës: Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës :

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar – A keni diçka të shtoni sa i përket Procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse nuk keni ndonjë vërejtje, unë do e lusë sekretarin e kuvendit që në faqe nr. 4 dhe 13 të i bëjnë përmirësimin e disa gabimeve teknike. Të nderuar anëtar të KPF-së e vë në votim Procesverbalit nga mbledhja e kaluar: Konstatoj se unanimisht është aprovuar pika e parë (1) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën kohore Janar- Shtator 2019.

Afrim Limani - I nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së dhe ju të gjithë të pranishëm. Kam kënaqësinë që para juve të raportoj raportin 9 mujor financiar të Komunës së Rahovecit. Ky raport është i përberë prej 3 pjesëve: Pjesa e të hyrave të buxhetit, pjesa e realizimit të buxhetit dhe pjesa e aktiviteteve të prokurimit. Në pjesën e të hyrave për këtë 9- mujorë kemi një inkasim të të hyrave në shumë prej 850, 809.32 € dhe nëse bëjmë një krahasim me vitin e kaluar kemi një ndryshim pozitiv prej 212,000.59 €, gjithashtu këtu kemi prezantua edhe një historikë të inkasimit të të hyrave për periudhën 9-mujore, kjo periudhë ka një inkasim më të mirë në relacion me vitet tjera. Gjithashtu i kemi të prezantuar edhe gjjobat e gjykatave që kanë një rritje në krahasim me vitin e kaluar, gjjobat e trafikut deri në muajin e nëntë kemi pasur inkasim 109,119.00 € me një ndryshim pozitiv në raport me vitin e kaluar në periudhën e njëjtë kohore prej 34,357.00 €, ndërsa gjjobat e gjykatave kanë një rënie në krahasim me periudhën e njëjte të vitit të kaluar me shumën 11, 204.00 €. Prandaj nëse i mbledhim të hyrat e rregullta së bashkë me gjjobat e gjykatave atëherë do të kemi një inkasim prej 994, 868.00 €, nëse e i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar atëherë është një ndryshim në total prej 190,195.00€. Në faqen nr. 6 kemi të prezantuar edhe të hyrat sipas kategorive ekonomike dhe sipas kodeve ekonomike, në faqen numër 7 kemi një tabelor që prezanton në mënyrë më të detajuar inkasimin e të hyrave të tatimit në pronë, ku për këtë 9-mujorë kemi pasur inkasim 371,129.00 €, me një ndryshim pozitiv në raport me periudhën e vitit të kaluar që është 90, 958.00, apo me një përqindje 32.47%. Te pjesa e realizimit të buxhetit në faqen 8 e kemi një tabelar që i pasqyron vetëm shpenzimet e buxhetit sipas kategorive në kuadër të programeve, ku shpenzimi i buxhetit për 9-muaj ka një vlerë prej

10, 433.00 €. Ndërsa në faqen numër 9 e kemi një tabelarë që prezanton shpenzimin e buxhetit në raport me planifikimin dhe në raport me alokimin, që do të thotë se buxheti për 9-muaj është shpenzuar në përqindje prej 75.82% , që realisht është i mirë dhe konsideroj që nuk rrezikohet deri në fund të vitit që eventualisht disa mjete të kalojnë në suficit, duke përfshirë të gjitha kategoritë. Ndërsa në faqen 11,12 deri 20 kemi të prezantuara shpenzimet e buxhetit në kuadër të mallrave dhe shërbimeve sipas kategorive duke përfshirë të gjitha programet dhe krejt në fund e kemi rekapitullimin e këtyre shpenzimeve sipas kategorive, në faqen 20 kemi të prezantuar shpenzimin e buxhetit në kuadër të shpenzimeve komunalë duke përfshirë rrymë, ujë, mbeturina, telefon dhe krejt në fund i kemi të prezantuara qartë edhe aktivitetet në kuadër të zyrës së prokurimit, ku janë disa të dhëna rreth aktiviteteve të kësaj zyre si: Data e nënshkrimit të kontratës, afati i implementimit, data e përmbylljes dhe çmimi i kontratës.

Rasim Fazliu- Përsëritje për të gjithë të pranishmit në sallë, falënderoj drejtorin për këtë raport financiar 9-mujor, unë desha të bëj një propozim ndoshta edhe kolegët do të më përkrahin meqenëse jemi duke mbajtur në vazhdimësi dhe edhe sot një trajnime prej DEMOS-it. Kisha propozuar që këtë pikë mos të diskutojmë sot, ne jemi edhe anëtarë të Kuvendit prandaj propozoj që këtë pikë ta diskutojmë në mbledhje të Kuvendit në mënyrë që të mbërrimë me kohë edhe sot për punëtorinë që e kemi.

Fehmi Cena – Përsëritje për të gjithë të pranishmit, nëse shumica e kolegëve nga KPF-ja pajtohen me propozimin e z. Rasim Fazliu që ne ta kalojmë këtë pikë për kuvend pa e diskutuar në hollësi, do pajtohesha edhe unë, meqenëse edhe ashtu kemi për ta diskutuar në mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi- Ju faleminderit për diskutimin e bërë, e vë në votim propozimin e z. Rasim Fazliu që kjo pikë të kalojë në Kuvend pa u diskutuar: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar që pika e dytë e rendit të ditës të kalojë në Kuvend për shqyrtim. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Informatës së DKA-së për fillimin e vitit të ri shkollor 2019-2020.

Avni Morina- Përsëritje për të gjithë të pranishmit, të nderuar pasi që keni për të shkuar në Prishtinë në një punëtori, unë nuk do të zgjas shumë, ju po ashtu informatën e keni para vete. Jam munduar të pasqyroj gjithë aktivitetet e DKA-së në lidhje me fillimin e vitit të ri shkollor, kam folur diçka aty rreth konkursit që ka qenë në fund të gushtit si rezultate të sistemit dhe ri sistemit të punëtorëve në sistemin arsimorë. Pastaj kam folur për shpërndarjen e librave, teksteve shkollore që na kanë ardhur nga Ministria e Arsimit, për mungesën e disa prej tyre, kam folur për përgatitjet që janë bërë në rinovimin e disa shkollave, kam folur diçka për ngrohjen qendrore në 3 shkolla, për drenazhimin dhe hidroizolimimin që po bëhet në dy shkolla. Kam folur për luterjet që po bëhet në shkollën fillore në Xërxë dhe Pataqan të Poshtëm, ka vazhduar ndërtimi i objekteve shkollore projekteve që janë në vazhdim në Hoçë, Brestovc, Retijë. Kam cekur që ka filluar ndërtimi i shkollës në Fortesë, ndërtimi i çerdhës në Ratkoc, është lidhur kontrata për çerdhën në Krushë, kemi lidhur një kontratë me DKRS-në për furnizim me libra për bibliotekat e shkollave e kështu me radhë. Pra janë pasqyruar disa aktivitete që janë bërë brenda kësaj periudhe, nëse keni ndonjë pyetje jam këtu për të ju përgjigjur.

Kryesuesi- Ju faleminderit drejtor, të nderuar të pranishëm, ju informoj se Raporti Financiar është i publikuar edhe në faqen e komunës. Atëherë ka dikush të shtoj diçka rreth pikës së 3 të rendit të ditës?

Fehmi Cena-Faleminderit kryesues, fillimisht falënderoj drejtorin e DKA-së për këtë raport që na ka prezantuar për fillimin e vitit të ri shkollor 2019-2020. Meqenëse e kemi kohën e kufizuar dhe pasi që pika e dytë nuk u shqyrtua hollësisht propozoj që edhe kjo pikë të kaloj për mbledhjen e ardhshme, pastaj edhe këtë së bashku me pikën tjetër do të shqyrtojmë hollësisht në Kuvend.


Kryesuesi – Të nderuar e vë në votim propozimin e z. Fehmi Cena: Konstatoj se është aprovuar në mënyrë unanime propozimi i z. Cena që edhe pika e tretë e rendit të ditës ta kalojë për mbledhje të Kuvendit pa u shqyrtuar në KPF. Kalojmë në pikën e fundit të KPF-së:

4. Të Ndryshme.

A ka dikush të diskutoj sa i përket pikës së fundit të rendit të ditës, nëse jo të nderuar ju falënderoj për kontributin e dhënë, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja përfundoj në 10:20

Procesmbajtësi,


Agim Hoti

